

Në kuadër të fillimit të vitit akademik 2024 - 2025, zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it në bashkëpunim me zyrën e Standarteve dhe Kurrikulave organizuan takime informuese me studentët e vitit të parë për çdo fakultet. Këto takime u organizuan me qëllim informimin e studentëve me programet e studimit që ata ndjekin, prezantim të stafeve akademike, strukturave drejtuese dhe administrative të universitetit.

Prezantimin e zyrës së Këshillimit të Karrierës, zyrë e cila i mbështet ata gjatë viteve të studimit akademik me qëllim njohjen e tyre me funksionet dhe shërbimet që ajo ofron në mbështetje të karrierës së tyre.



